

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

Nr.Rendor	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Përgjigje	Tarifa
1.	Gjate muajve Janar, Shkurt dhe Mars nuk ka pasur kërkesa per informacion			
	18.1.2024	Kërkesë për informacion	<p>Ne pergjigje te kerkeses suaj lidhur me nivelin e ndotjes se ajrit ne qytetet e Tiranes, Dimalit, Krujes, Kurbinit dhe Selenices, ISHP, nuk disponon te dhena.</p> <p>Monitorimin e treguesve te cilesise se ajrit ne disa prej qyteteve kryesore te vendit e kryen Agjencia Kombetare e Mjedisit</p>	
3.	30/04/2024	Kerkese per informacion	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kur do të nis dezinfektimi i mushkonjave me BIT? Shërbimi i dezinfektimit i cili bazohet në kontrollin larvor të larvave të mushkonjave me agjentin biologjik Bti ka filluar tashmë në zonat bregdetare dhe urbane, në datë 02.05.2024. 2. Cilat janë zonat që pritet të përfshihen në këtë proces? Zonat e përfshira në këtë proces gjate vitit 2024 janë si më poshtë: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”, 	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<ul style="list-style-type: none">• Shkodër • Velipojë“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”• Tiranë• Plazhi Golem-Qerret• Plazhi Spille“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”• Shën Pjetër dhe Gjiri i Lalzit• Durrës dhe Plazhi Plepa“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”• Divjakë dhe plazh• Fier• Darëzezë, Plazhi i Semanit“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”• Vlorë (plazh-Nartë-Zvërrnec)• Rradhimë• Orikum• Dhërmi• Jalë• Himarë-Livadh• Qeparo• Borsh• Bunec• Sarandë• Çukë	
--	--	--	--	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<ul style="list-style-type: none">• Ksamil• Parku Kombëtar i Butrintit dhe zonat përreth. <p>3. Sa pritjet të zgjas ky proces afati kohor?</p> <p>Procesi pritjet të vazhdojë deri në muajt shtator/tetor në varësi të kushtëve klimatike dhe problematikave që mund të shfaqen nga mushkonjat.</p> <p>4. A ka ndonje studim ISHP për sëmundshmërinë apo efektet që ka në popullatë pickimi nga mushkonjat? Nese po, na e vini në dispozicion.</p> <p>ISHP ka bërë studime lidhur me llojet e mushkonjave që gjenden në vendin tonë dhe rolin e tyre në transmetimin e patogjenëve të ndryshëm. Më poshtë po listojme disa prej tyre: Mercier, A., Obadia, T., Carraretto, D., Velo. E., Gabiane. G., Bino. S., Vazeill. M., Gasperi. G., Dauga, C., Malacrida. A.R., Reiter. P., & Failloux. AB. “Impact of temperature on dengue and chikungunya transmission by the mosquito <i>Aedes albopictus</i>.” Sci Rep 12, 6973 (2022). https://doi.org/10.1038/s41598-022-10977-4 ööö.nature.com/articles/s41598-</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>022-10977-4.pdf origin=ppub Prudhomme J, Fontaine A, Lacour G, Gantier JC, Diancourt L, Velo E, Bino S, Reiter P, Mercier A. “The native European Aedes geniculatus mosquito species can transmit chikungunya virus.” Emerg Microbes Infect. 2019; 8(1):962-972. doi: 10.1080/22221751.2019.1634489. PMID:31259662 Free PMC Article ”Udhëzues mbi kontrollin e vektorëve dhe rodentëve në Shqipëri” http://ëëë.ishp.gov.al/multimedia/UdhezuesMbiKontrollinEvektoreveDheBrejtesveNeShqiperi.pdf.</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Sa i rëndësishëm është ky proces. 6. Ky proces është i rëndësishëm për të mbajtur nën kontroll dendësinë e popullatave të mus hkonjave me qëllim evitimin e transmetimit të patogjenëve që ato mund të transmetojnë dhe për të ulur bezdisjen nga pickimet prej tyre. 	
4.	27/05/2024	Kerkese per informacion	Bazuar në kërkesën tuaj ju bejmë me dije se :	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			Vlera e kontratave të lidhura në vitin 2024 të cilat janë në proces likuidimi është 5,325,403 lekë pa TVSH dhe 6,390,484 lekë me TVSH.	
5.	14.6.2024	Kërkesë për info	<p>Bazuar në studimet entomologjike të kryera në vendin tonë janë identifikuar të pranishme këto gjini kryesore të mushkonjave: <i>Anopheles</i>, <i>Aedes</i>, <i>Culex</i> dhe <i>Culiseta</i>.</p> <p>Aktualisht në zonat urbane qarkullojë dy lloje kryesore mushkonja e zakonshme <i>Culex pipiens</i> e cila është vector i etheve të Nilit Perëndimor dhe mushkonja tigrë <i>Aedes albopictus</i> e cila është e aftë të transmetojë virusin e Chikungunjës, Zikës, etheve Dengue etj.</p> <p>Ndërsa në zonat bregdetare llojet kryesore të pranishme në këtë periudhë janë <i>Aedes detritus</i>, <i>Aedes vexans</i>, <i>Aedes caspius</i>, <i>Culex pipiens</i> dhe <i>Aedes albopictus</i>. Mushkonjat <i>Aedes detritus</i>, <i>Aedes vexans</i>, <i>Aedes caspius</i> janë bezdisëse me pickimet e tyre në mbrëmje dhe gjatë natës.</p> <p>Në kuadër të masave të marra për kontrollin e mushkonjave në zonat</p>	

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>bregdetare dhe urbane në datë 02.05.2024 në bashkëpunim me pushtetin lokal ka filluar shërbimi i dezinfektimit në disa qarqe të vendit si më poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none">• Qarku Shkodër (Shkodër, Velipojë),• Qarku Tiranë (Tiranë, plazhin e Golemit-Qerretit dhe plazhin e Spillesë)• Qarku e Durrës (Shën Pjetër dhe Gjiri i Lalzit, Durrës dhe Plazhi Plepa)• Qarku Fier (Divjakë dhe plazh, Fier, Darëzezë, Plazhi i Semanit)• Qarku Vlorë (Vlorë (plazh-Nartë-Zvërrnec, Rradhimë, Oriku, Dhërmi, Jalë, Himarë-Livadh, Qeparo, Borsh, Bunec, Sarandë, Çukë, Ksamil, Parku Kombëtar i Butrintit dhe zonat përreth) <p>Deri tani janë kryer tre trajtime ne Qarkun e Shkodrës, Tiranës, Fierit. Në Qarkun e Durrësit dhe Vlorës kanë përfunduar dy trajtime dhe do të vazhdohet me trajtimin e tretë në javët në vijim.</p> <p>Duke qene se mushkonja tigrë <i>Aedes albopictus</i> zhvillohet në vatra të krijuara në mënyrë</p>
--	--	--	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>artificiale nga njërëzit që përshijnë kova me ujë, fuçi, lodra të harruara në oborr, pishinat e plazhit, pjatat e vazove të luleve, gomat e përdorura të makinave, lulet dekorative, puseta etj., në procesin e dezinfektimit është integruar ndërhyrja derë më derë në mjedise publike dhe private të vlerësuara nga ana e Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor përkatës, si zona “hot spot” të nxehta për zhvillimin e larvave të mushkonjave.</p> <p>Gjatë këtyre ndërhyrjeve po bashkëpunohet me komunitetin e zonave të përcaktuara, duke e informuar atë lidhur me vendet e zhvillimit të larvave të mushkonjave brenda dhe përreth banesave të tyre, rolin dhe përfshirjen e tyre në këtë proces, si dhe është bërë evidentimi dhe trajtimi apo eliminimi i vatrave të zhvillimit të larvave.</p> <p>Procesi parashikohet të kryhet deri në muajt shtator/tetor m e një frekuencë tre javore në varësi të kushtëve klimatike dhe problematikave që mund të shfaqen nga mushkonjat.</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			Aktualisht nuk kemi sëmundje të trasmetuara nga mushkonjat në vendin tonë, por është mjaft e rëndësishme informimi dhe përfshirja e komunitetit në mënyrë aktive për eliminimin e vendeve ku zhvillohen larvat e mushkonjave brenda mjediseve të banesave dhe në lagjen ku jetojnë, për të ulur nivelin e bezdisjes nga pickimet dhe mundësinë e transmetimit të patogjenëve.	
6.	18.07.2024	Kërkesë për informacion	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, sqarojmë se: Referuar dhe në zbatim të VKM Nr 379 datë 25.06.2016, neni 20, neni 21, Për miratimin e Rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm nuk është kompetencë e Institutit të shëndetit Publik	
6.	2.09.2024	Kërkesë për informacion	Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: 1. Numri i testeve në total deri në datë 15 shtator është 256 nga të cilat 92 janë të konfirmuar dhe 45 të mundshme. 2. Gjithashtu përveç hetimit epidemiologjik është kryer hetimi entomologjik dhe janë dërguar	

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>rekomandimet përkatëse lidhur me masat që duhet të meren në vatra dhe përreth tyre për kontrollin e vektorit të transmetimit dhe për të parandaluar shfaqjen e rasteve të reja sipas çdo rasti dhe problematikës së vënë re.</p> <p>Gjithashtu në disa nga bashkitë si ajo e Lezhës, Kurbinit, Lushnjes, Fierit, Roskovecit dhe Vlorës janë bërë dhe takime në vend. Ju sqarohet se procesi i dezinfektimit ka vijuar të kryhet në zonat bregdetare dhe urbane që nga muaji Maj e në vijim, sipas gjetjeve në terren dhe kërkesave të Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor të zonave të përfshira në këtë proces: Shkodër, Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnje, Fier dhe Vlorë. Po ashtu të gjitha rastet janë vënë re në zona që nuk janë zonat e programit të dezinfektimit (bregdeti)</p> <p>3. ISHP ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha rastet e konfirmuara dhe të mundshme në bashkëpunim me NJVKSH përkatëse dhe mjekët në QSUT, mjekë të spitaleve rajonale apo mjekë të familjes. Nuk ka asnjë rast që nuk është monitoruar dhe ndjekur. Gjithashtu ju bëjmë me dijeni se për Ethet e Nilit</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			Perëndimor nuk ka trajtim specifik etiologjik por vetëm trajtim mbështetës.	
	3.10.2024	Kërkesë për informacion	<p>KANCERI I GJIRIT NË SHQIPËRI Pamja epidemiologjike e kancerit të gjirit në vendin tonë është shumë e ngjashme me mesataren e popullatës së botës. Ashtu si në nivel global, edhe në Shqipëri, kanceri i gjirit përbën më shumë se 11 % të të gjitha rasteve të reja me kancer të diagnostikuara çdo vit, ndërkohë që vlerësohet se rreth një e katërta e të gjitha grave në popullatë që jetojnë me një neoplazi malinje, kanë kancer gjiri. Në terma të riskut (në përpjestim me popullatën që e prodhon sëmundjen) kanceri i gjirit është kanceri me riskun më të lartë në Shqipëri, në distancë nga kanceret e tjera. Në vitin 2023, u diagnostikuan 744 femra me kancer të gjirit në të gjithë vendin ose 61.4 për 100,000 femra. Në 2023 u diagnostikuan gjithashtu edhe 15 kancere gjiri te meshkujt. Vlerësohet të jenë rreth 5,000 gra që jetojnë me këtë sëmundje në vendin tonë. Risku për tu diagnostikuar nga kanceri i gjirit rritet me moshën deri në 70 vjeç.</p>	

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>Risku maksimal është në moshën 50 deri 70 vjeç. Pas kësaj moshe vërehet një rënie. Risku është shumë i ulët por jo zero në moshën 20-30 vjeç. Rastet e reja me kancer gjiri te femrat sipas grup-moshave për periudhën 2015-2023</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 10%;">2015</td> <td style="width: 10%;">2016</td> <td style="width: 10%;">2017</td> <td style="width: 10%;">2018</td> <td style="width: 10%;">2019</td> <td style="width: 10%;">2020</td> <td style="width: 10%;">2021</td> <td style="width: 10%;">2022</td> <td style="width: 10%;">2023</td> <td style="width: 10%;">Total</td> </tr> <tr> <td>653</td> <td>698</td> <td>713</td> <td>708</td> <td>719</td> <td>628</td> <td>714</td> <td>710</td> <td>744</td> <td></td> </tr> </table> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka nisur nga Elbasani fushatën kombëtare të tetorit rozë për parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit me sloganin “Ja vlen të jetosh”. Çdo ditë nga data 1 deri në 31 Tetor, nga e hëna në të premtë, nga ora 8 e mëngjesit deri në 8 të darkës dhe të shtunën nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 2 të drekës, do të mundësohen kontrollet/mamografitë, në spitalet apo qendrat pranë vendbanimit. Gratë 50-70 vjeç, duhet të kujtohen për të bërë periodikisht mamografinë e radhës. Krahas qendrave spitalore qendrore e rajonale, në dispozicion janë edhe dy njësitë lëvizëse të mamografive që mundësojnë kryerjen e mamografisë edhe në zonat më të thella të Shqipërisë. Sjelljet dhe</p>	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total	653	698	713	708	719	628	714	710	744		
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total															
653	698	713	708	719	628	714	710	744																

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>ndërrhyrjet në stilin e jetesës që ulin rrezikun e kancerit të gjirit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushqyerja e zgjatur me gji, • Aktivitet i rregullt fizik, • Kontrolli i peshës trupore, • Shmangia e përdorimit të dëmshëm të alkoolit, • Shmangia e duhanpirjes, • Shmangia e përdorimit të zgjatur të terapive hormonale, • Shmangia e ekspozimit të tepërt ndaj rrezatimit. Nëse të gjithë faktorët e rrezikut potencialisht të modifikueshëm do të mund të kontrolloheshin, kjo do të zvogëlonte rrezikun e zhvillimit të kancerit të gjirit me më së shumti 30%. Prandaj zbulimi dhe kapja e hershme e kancerit të gjirit, si rrjedhojë dhe trajtimi i hershëm, shpëton jetën, rrit shumë mundësinë e shërimit të plotë dhe përmirëson cilësinë e jetës. 	
8.	1.11.2024	Kërkesë për informacion	<p>Ju lutem gjeni më poshtë përgjigjet për pyetjet tuaja:</p> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është numri i këtyre rasteve për periudhën janar 2022- tetor 2024? 2. Si është trendi i këtyre sëmundjeve? 3. Cilat grup moshë janë, më të prekura? 	

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>4. Nëse do t'i ndanim sipas gjinisë, kush janë më të prekur femrat apo meshkujt?</p> <p>Të dhënat mbi përdorimin e shërbimeve për probleme të shëndetit mendor raportohen ne OSHKSH dhe MSHMS. Instituti i Shëndetit Publik e përqendron aktivitetin e tij për këtë çështje në kërkimin shkencor si dhe aktivitete ndërgjegjësuese për promovimin e shëndetit mendor për të gjitha grup moshat, përfshirë edhe fëmijët. Studimi i fundit i HBSC 2021-2022 i kryer në fëmijët e moshës shkollore 11, 13 dhe 15 vjeç në Shqipëri ofron rezultatet e mëposhtme, të cilat i japin përgjigje edhe pyetjeve tuaja:</p> <ul style="list-style-type: none">• Treguesi i mirëqënies (WHO-5: ndjehen në humor të mirë, të qetë, të çlodhur, aktivë, dhe jeta e mbushur me gjëra interesante – nga aspak ne gjithë kohën gjate dy javëve te fundit – nga 0-100) Mesatarja e treguesit te mirëqënies për Shqipërinë: 60 për vajzat dhe 72 për djemtë. Shume me larte se mesatarja ne Evrope (50% për vajzat dhe 62% për djemtë).• Treguesi i kënaqësisë me jetën (Shkalla Cantril vizuale: nga 0 me keq - 10 me mire). Shqipëria: 8.5	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>djemtë dhe 7.9 vajzat. Mesatarja Evropiane 7.5 dhe 6.8. Për 11 vjeçarët Shqipëria 9.2 për te dy gjinitë. Për 13 vjeçarët Shqipëria 8.9 dhe 8.5. Gjithmonë shume me lart se mesatarja Evropiane</p> <ul style="list-style-type: none">• Vetmia. Ne Shqipëri 19% e vajzave dhe 8% e djemve 15 vjeç ndjeheshin te vetmuar shumicën e kohës ose gjithmonë. Vlerat rriten me rritjen e moshës. Mesatarja evropiane është 28% me 13%.• 57% e vajzave dhe 34% e djemve 15 vjeçarë kane pasur te paktën 2 shenja te lidhura me stresin (vështirësi me gjumin, irritim, marrje mendsh, dhembje stomaku, dhembje koke, nervoz, te mërzitur, me shume se 1 here ne jave gjate 6 muajve te fundit). Mesatarja Evropiane është 66% me 36%. Ka një rritje te lehte krahasuar me 2014 dhe 2018 ne te gjithat vendet përfshi Shqipërinë dhe vlerat rriten me rritjen e moshës.• 73% e vajzave dhe 76% e djemve 15 vjeç ja dalin ti kryejnë gjerat qe donin ti kryenin shumicën e kohës ose gjithmonë (self-efficacy) <p>Mesatarja Evropiane është respektivisht 52% dhe 64%. 5. A ka nevojë për ndryshim ligji aktual? Kuadri ligjor dhe</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2024

			<p>rregullator për shëndetin mendor në Shqipëri është gjithëpërfshirës dhe aktualisht nuk janë identifikuar nevoja për ndryshime.</p> <p>Referenca: A focus on adolescent mental health and well-being in Europe, central Asia and Canada. Health Behaviour in School-aged Children international report from the 2021/2022 survey. Volume 1 https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/373201/9789289060356-eng.pdf?sequence=2</p>	
9.				
10.				
11.				